



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

# POLITIKA E NDRYSHIMEVE TË METODOLOGJISË

---

---

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Bul. "Zhan D'ark", Nr. 3, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

## Tabelë Përmbledhëse

1. Hyrje.....	2
2. Përkufizime .....	3
3. Rastet e ndryshimit të metodologjisë.....	3
4. Aspekte të përgjithshme.....	4
5. Analiza e ndryshimeve metodologjike .....	5
5.1 Avantazhet: .....	5
2) Kufizimet .....	6
3) Kosto dhe risqe .....	6
6. Aspekte të detyrimit të prodhuesve të statistikave lidhur me ndryshimet metodologjike .....	7
7. Rregullat e zbatimit të ndryshimeve metodologjike.....	7

## 1. Hyrje

Përcaktimi i një politike të ndryshimeve metodologjike për INSTAT është një hap tjetër i rëndësishëm drejt zbatimit të Kodit të Praktikës të Statistikave Europiane dhe pasqyrimin të angazhimit të INSTAT nëpërmjet Ligjit të Statistikave Zyrtare për të prodhuar statistika cilësore, të paanshme dhe objektive, koherente dhe të krahasueshme, me një metodologji të përshtatshme, duke siguruar të drejtën e hyrjes dhe qartësinë e informacionit.

Politika e Ndryshimit të Metodologjisë është një komponent i Politikës së Rishikimit të të Dhënave Statistike dhe ndjek vizionin e sistemit të integruar statistikor evropian, i cili kërkon koordinimin dhe sinkronizimin e publikimit dhe rishikimit të statistikave, transparencë maksimale për përdoruesit, nëpërmjet një komunikimi të qartë të politikave dhe praktikave të rishikimit.

Politika e Ndryshimit të Metodologjisë rrit vetëdijen mbi cilësinë statistikore dhe nivelin e përputhshmërisë me *acquis communautaire* duke kontribuar në kalimin, sa herë që është i nevojshëm, në praktika më të mira. Në bazë të kësaj politike, përdoruesit e statistikave mund të gjejnë arsyen pse, si dhe kur ndryshon një metodologji e caktuar, si përcaktohet koha e nevojshme për zbatimin e ndryshimit dhe masat e marra për të identifikuar hendekun e krijuar në vlerat e treguesve dhe impaktin e këtyre ndryshimeve.

Politika e ndryshimeve metodologjike përbën bazën mbi të cilën ngrihet procesi i dokumentimit të politikave specifike të ndryshimit të metodologjisë. Politikat specifike të ndryshimit të metodologjisë ndërtohen për secilin aktivitet i cili kalon një proces rishikimi të përkufizimeve, metodave, klasifikimeve të cilat mund të ndiqen nga rishikime të produkteve statistikore ekzistuese, apo të sjellin produkte krejtësisht të reja me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm dhe një përputhshmërinë me standartet evropiane.

Parimet e Politikës së Ndryshimit të Metodologjisë paraprihen nga nevoja të rritjes së cilësisë së statistikave dhe përafrimit me *acquis*, por ndryshime të tilla mund të lindin edhe si rrjedhim i kërkesave kombëtare në linjë me standartet ndërkombëtare. Kjo politikë, që do të mbështetet edhe nga një numër dokumentesh ku do të përfshihen ndryshimet metodologjike specifike, do të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e kulturës statistikore dhe përmirësimin të imazhit të institucionit.

Politika e Ndryshimit të Metodologjisë konsiderohet një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes së mirë të statistikave.

## 2. Përkufizime

Politika e Ndryshimit të Metodologjisë përdor përkufizimet e mëposhtme:

**Metodologji** – Teoria dhe metodat e mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe analizës të tyre.

**Ndryshim metodologjik** – çdo ndryshim në përkufizime, klasifikime apo metoda të përdorura në proceset e hartimit, mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Ndryshimet metodologjike bëhen për arsyet e mëposhtme: kur zbatohet një vit bazë i ri ose një procedurë e modifikuar llogaritjeje, kur bëhet e disponueshme një bazë e re të dhënash ose kur një bazë e dhënash ekzistuese bëhet e papërdorshme, apo kur aplikohen klasifikime/përkufizime të reja. Ndryshimet metodologjike bëhen për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe rëndësinë që ato kanë për përdoruesit. Prodhuesit e statistikave përpiqen t'i mbledhin dhe përqëndrojnë ndryshime të tilla në pak herë (sipas mënyrës “bing bang”) në mënyrë që ta reduktojnë ngarkesën e përdoruesve sa më pak të jetë e mundur.

**Acquis communautaire** - (shkurt *acquis*), është legjislacioni i grumbulluar, aktet ligjore dhe vendimet e gjykatës që përbëjnë trupin e ligjit të Bashkimit Evropian. Termi është Frëngjisht: *acquis* do të thotë "ajo që është marrë ose fituar", dhe *communautaire* ka kuptimin “i komunitetit”.

**Aktivitet statistikor** - është një proces, ose një kombinim i proceseve që japin si rezultat një produkt statistikor.

**Tregues statistikor** – është një element i të dhënave që përfaqëson të dhënat statistikore për një kohë, vend dhe karakteristika të tjera të përcaktuara.

## 3. Rastet e ndryshimit të metodologjisë

Ndryshimet metodologjike në prodhimin statistikor në Shqipëri synojnë një pasqyrim të përmirësuar të realitetit, statistika të krahasueshme dhe në të njëjtën kohë të harmonizuara me vendet europiane e më gjerë dhe nisen nga nevoja thelbësore:

- 1) **Kërkesa për një përputhje gjithnjë e më të madhe me statistikat europiane si vend kandidat në BE:** Statistikat në Shqipëri, megjithëse relativisht të reja, kanë njohur një zhvillim progresiv që është ndihmuar në kohë nga ekspertiza ndërkombëtare. Mbështetja është fuqizuar sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit nga kontaktet e rregullta me Eurostat. Programi i Statistikave Zyrtare (i përditësuar çdo 5 vjet) ka si qëllim të rrisë përputhjen me Kompendiumin Statistikor Evropian në dy drejtime: zgjerimin e prodhimit statistikor

nëpërmjet shtimit të aktiviteteve dhe treguesve të rinj statistikorë; dhe përputhjen metodologjike për prodhimin e treguesve ekzistues.

Në këtë kontekst, përveç përfshirjes së vrojttimeve/burimeve të reja për të prodhuar tregues statistikorë të paprodhuar më parë, mund të ndodhë që të ndryshojë krejtësisht burimi nga i cili përftohen të dhënat, i cili mund të ketë qënë i kufizuar nga:

- a. disponibiliteti i të dhënave deri në një moment të caktuar kohe;
- b. metodologji e përdorur sipas standarteve/praktikave të pranuar në nivel ndërkombëtar por të ndryshme nga metodat e përdorura nga vendet anëtare të BE;
- c. nevojat kombëtare (si p.sh. legjislacioni) të cilat kanë ndikuar në prodhimin e statistikave që nuk janë në linjë me acquis të BE-së, por që i përgjigjen nevojës për të monitoruar impaktin e politikave të ndjekura për zhvillim dhe mirëqenie në vend.

- 2) **Përditësimi i vazhdueshëm i metodologjisë së Eurostat:** edhe metodologjia e zbatuar tashmë në përputhje me acquis duhet të mbahet në përditësim të vazhdueshëm meqënëse edhe vetë Eurostat është në proces të vazhdueshëm të përmirësimit dhe harmonizimit të metodave, përkufizimeve dhe mjeteve të kontrollit të cilësisë së produkteve statistikore. Kompendiumi Statistikor Europian përditësohet vazhdimisht për të marrë parasysh ligjet dhe zhvillimet e tjera të rëndësishme për statistikën europiane;
- 3) **Burime të dhënash të shtuara ose të përmirësuara dhe aplikimi i praktikave më të mira:** në prodhimin e statistikave ekzistuese mund të shtohen ose të përmirësohen të dhëna, mungesa e të cilave nuk mundëson zbatimin e praktikave “më të mira”. Përdorimi i këtyre praktikave mund të sjellë ndryshime në statistikën e prodhuara me bazë ndryshimin metodologjik dhe mund të përfshijë në disa raste një zinxhir rishikimesh për të arritur koordinimin dhe konsistencën e duhur edhe në fushat e tjera statistikore.
- 4) **Propozime të lëna në kuadër të vlerësimeve të prodhimit statistikor:** Eurostat por dhe organizata të tjera të certifikuar në fushën e të dhënave statistikore kryejnë vlerësime të rregullta dhe periodike përsa i përket statistikave në Shqipëri nëpërmjet raporteve të progresit, nënkomitetit për statistika ekonomike dhe financiare, vlerësimit të përgjithshëm të përshtatur për vendet candidate, vlerësimeve *Peer Review* etj. të cilat mund të përfshijnë rekomandime që sjellin nevojën për ndryshime metodologjike.

## 4. Aspekte të përgjithshme

Ndryshimet metodologjike nuk duhet të konsiderohen një fenomen i jashtëzakonshëm. Ato janë në fakt një aspekt i “qeverisjes së mirë” statistikore që pasqyron transparencën dhe përgjegjësinë nga ana e sektorit shtetëror. Megjithatë, duhet të jemi të vetëdijshëm se ndryshime të tilla mund të sjellin impakte të rëndësishme në rezultatet dhe analizat e situatës ekonomike dhe sociale mbi të cilat janë bazuar politika të caktuara.

Në këtë kontekst, rëndësia e ndryshimeve që përmirësojnë pasqyrimin e realitetit duhet të shkojë në të njëjtin drejtim me rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të një politike që i pajis përdoruesit me një guidë në këtë proces. Politika e përgjithshme e ndryshimeve metodologjike krijon bazën mbi të cilën do të mbështeten zhvillimet e politikave specifike për fusha të ndryshme të statistikave në mënyrë që të merren parasysh dhe specifikat e secilës prej tyre.

Gjithashtu ndryshimet metodologjike nuk duhet të ngatërrohen me rishikimet e të dhënave. Ato mund të jenë një nga shkaqet për të cilat ndodh procesi i rishikimit dhe në këtë kuptim Politika e Ndryshimeve Metodologjike konsiderohet një pjesë e Politikës së Rishikimit Statistikor.

Parimi mbi të cilin mbështeten ndryshimet metodologjike janë rritja e vazhdueshme e cilësisë dhe veçanërisht saktësisë së të dhënave dhe në të njëjtën kohë gjetja e një balance përsa i përket zëvendësimit apo rishikimit të metodave. Në këtë proces, një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe komunikimi me publikun nëpërmjet dokumentimit, analizave dhe shpërndarjes në mënyrë sa më vizuale të informacionit që shoqëron ndryshimet. Informacioni mbi ndryshimet metodologjike duhet të parashikojë një komunikim sa më efektiv me mediat dhe të paraqitet në njoftimet për shtyp, në publikime dhe materiale të vendosura në faqen zyrtare.

## **5. Analiza e ndryshimeve metodologjike**

Aplikimi i ndryshimeve metodologjike nëpërmjet një politike të mirëpërcaktuar dhe në koherencë me standartet e pranuar të prodhimit të statistikave ka një sërë avantazhesh por edhe kufizimesh dhe kërkon njëkohësisht marrjen parasysh të kostove dhe rreziqeve të mundshme si më poshtë:

### **5.1 Avantazhet:**

- Ndryshimet metodologjike që vijnë si rezultat i analizave dhe studimeve në nivel kombëtar apo ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e cilësisë së prodhimit statistikor dhe një pasqyrim më të mirë të realitetit. Ato rrisin nivelin e krahasueshmërisë ndërmjet vendeve duke iu përgjigjur nevojave në rritje të politikave të përgjithshme të zhvillimit.
- Ndryshimet metodologjike shmangin pasaktësitë apo problemet në të dhënat ekzistuese (si rrjedhim i mungesës së të dhënave të përshtatshme për nevojat e llogaritjeve të statistikave përkatëse) duke sjellë përmirësime edhe në fusha të tjera statistikore.
- Ndryshimet metodologjike mund të sjellin, përveç përmirësimeve në drejtim të saktësisë së të dhënave, edhe përmirësime lidhur me kohën e disponibilitetit të tyre. Qëllimi është që përdoruesit të furnizohen me të dhëna të freskëta, që i referohen ngjarjeve të ndodhura në kohë

reale, në mënyrë që edhe reagimi i politikave apo impakti që rrjedh nga zbatimi i tyre të jetë sa më efektiv.

- Një politikë e mirëpërcaktuar e ndryshimeve metodologjike i jep përdoruesve në dorë një mjet për të kuptuar arsyet e qënësishme të ndryshimeve në prodhimin statistikor, rrit cilësinë e dokumentimit të tij në funksion të transparencës dhe kuptueshmërisë së proceseve statistikore duke rritur në këtë mënyrë besueshmërinë e përdoruesve. Vetëdija se në këtë proces ata janë të rëndësishëm ndikon direkt edhe në rritjen e imazhit të mirë të institucionit.

- Një politikë e hapur dhe gjithëpërfshirëse e ndryshimeve metodologjike ndihmon jo vetëm prodhuesit e një fushe të caktuar të cilës i përkasin këto ndryshime por edhe prodhuesit dhe përdoruesit e fushave të tjera lidhur me të. Në këtë mënyrë bëhet e mundur njohja me praktikën e ndryshme të marra në studim dhe shtohet bashkëpunimi dhe bashkë-autorësia në vendim-marrjen për zgjedhjen e praktikave më të mira duke studiuar njëkohësisht impaktin e zbatimit të tyre.

## 2) Kufizimet

- Pavarësisht dobive të aplikimit të ndryshimeve metodologjike, duhet marrë në konsideratë edhe fakti që ndryshimet duhet të jenë të rralla, të mirë-studiuara dhe vërtet të nevojshme meqënëse ndryshime të shpeshta nxisin pasiguri përsa i përket besueshmërisë së të dhënave.

- Është e nevojshme të gjendet balanca e duhur midis qëndrueshmërisë së një serie kohore dhe nevojës për të ndryshuar si rezultat i përfshirjes së metodave, koncepteve, klasifikimeve të reja etj.

- Nganjëherë mund të jetë e gabuar e kundërta: të cilësohen si më të besueshme seritë kohore të pandryshuara përkundrajt të dhënave të cilat bëhen subjekt i revizionimit si rrjedhojë e ndryshimeve metodologjike.

- Një ndryshim metodologjik që përfshin rishikime të të dhënave të mëparshme duhet studiuar me kujdes për impaktin e tyre, sepse ndryshime të vogla në agregate të dhënash mund të fshehin ndryshime të konsiderueshme kur dizagregohen në nivele më të ulëta.

## 3) Kostot dhe risqet

- Disa përdorues mund t'i konsiderojnë ndryshimet metodologjike si një dukuri shqetësuese përse i përket analizave të tyre, sidomos kur nuk ka një strategji, paralajmërim apo dokumentim për aplikimin e tyre.

- Procesi që shoqëron ndryshimet metodologjike, sidomos kur impakti i tij shtrihet mbi seri të dhënash, harxhon kohë dhe burime njerëzore. Prodhuesve i takon të bëjnë punë shtesë duke bërë llogaritje dhe rishikime të të dhënave ndërsa përdoruesve i duhet të rindërtojnë skedarët dhe analizat e tyre.

## **6. Aspekte të detyrimit të prodhuesve të statistikave lidhur me ndryshimet metodologjike**

Efektet e ndryshimeve metodologjike janë si dy anë të së njëjtës medalje për prodhuesit e statistikave. Nga njëra anë, informacioni i ri i prodhuar është i nevojshëm për të përshkruar zhvillimet ekonomike dhe sociale me më shumë saktësi. Nga ana tjetër, ndryshime të shpeshta apo të thella metodologjike mund të ulin besueshmërinë e të dhënave statistikore sidomos tek përdoruesit jo të kualifikuar përsa i përket njohurive statikore. Për rrjedhojë, prodhuesit e statistikave duhet t'i mbajnë përdoruesit të përditësuar me praktikat e ndryshimeve metodologjike, rishikimeve dhe korrigjimit të gabimeve. Pasja e dokumenteve në të cilët deklarohet dhe rregullohet procedura e aplikimit të këtyre ndryshimeve, rrit besueshmërinë e përdoruesve dhe saktësinë e prodhuesve.

Është me shumë rëndësi që prodhuesit e statistikave të zbatojnë një politikë të mirë-dokumentuar, të standardizuar, të përditësuar dhe transparente ndryshimesh metodologjike. Kjo vlen si përsa i përket aspekteve të përgjithshme ashtu edhe plotësimin me politika specifike për fusha të caktuara meqënëse secila nga fushat statistikore ka specifikat e saj.

Politikat specifike të ndryshimeve metodologjike duhet të përfshijnë arsyet e ndryshimeve, kohën kur mund të ndodhin ndryshimet, thellësinë e impaktit që pritet, periudhën kohore në të cilën mund të shtrihet veprimi i tyre, analizimin e impaktit dhe nëse është e mundur krijimin e lidhjes në pikat e prerjes së serive kohore.

Politikat e ndryshimeve metodologjike, e përgjithshme dhe ato specifike, vendosen në faqen zyrtare të statistikave dhe i sigurohet vizibilitet edhe nëpërmjet linqeve në njoftimet për shtyp, publikimet, raportet e cilësisë si dhe metadatat. Publikimi i tyre jo vetëm rrit transparencën, besueshmërinë dhe kulturën statistikore për përdoruesit por nga ana tjetër nxit përmirësime në dokumentimin dhe përhapjen e informacionit nga ana e prodhuesve të statistikave.

## **7. Rregullat e zbatimit të ndryshimeve metodologjike**

Nevoja për të kryer ndryshime metodologjike mund të jetë përcaktuar që më parë në politikat specifike të ndryshimeve metodologjike për një fushë të caktuar ose mund të verifikohet në nivele të ndryshme të menaxhimit të prodhimit statistikor (specialist, përgjegjës, drejtor). Në çdo rast, procesi që shoqëron këto ndryshime ndjek një standart të përcaktuar.

1. Nëse verifikohet se në prodhimin statistikor ka vend për përmirësim apo ndryshim metodologjik, specialistët e fushës hartojnë një relacion që përmban punën paraprake studimore me arsyet e ndryshimit, përmirësimet që sjell, një vlerësim të kohës së duhur për ta zbatuar dhe impaktet që mund të shkaktojë.



2. Ky relacion paraqitet nga përgjegjësi i sektorit tek drejtori i drejtorisë i cili informon drejtorët e drejtorive të tjera, Koordinatorin e Cilësisë Statistike, dhe Drejtorin e Përgjithshëm. Në vijim, drejtori i drejtorisë pasi mbledh të gjithë komentet, sugjerimet apo propozimet nga kolegët lidhur me ndryshimin dhe shtrirjen e impaktit në statistikat që prodhon institucioni, propozon ngritjen e një Grupi Punë. Detyra e Grupit të Punës është të ndjekë përgatitjet për zbatimin e ndryshimit metodologjik dhe të analizojë gjerësinë dhe thellësinë e impaktit të këtij ndryshimi në prodhimin statistikor, jo vetëm brenda por dhe jashtë institucionit.

4. Puna për të përgatitur ndryshimin metodologjik fillon të kryhet brenda sektorit që prodhon statistikat përkatëse dhe njëkohësisht përfaqësuesit e statistikave të tjera të lidhura me to, analizojnë ndryshimet që do të ndodhin në treguesit e tyre duke shqyrtur edhe nevojën për të nisur një rishikim të serive kohore që prodhojnë. Në këtë fazë, Grupi i Punës kryen dhe takime informuese me prodhues apo përdorues të jashtëm që bazohen në statistikat ku po ndodh ndryshimi apo të lidhura me to. Koordinatori i Sistemit Statistikor krijon lidhjen me Agjensitë e tjera Statistike të cilat mund të dërgojnë përfaqësuesit e tyre si pjesë e Grupit të Punës nëse ndryshimet metodologjike kanë impakt në statistikat e prodhuara apo të analizuar nga ato.

5. Në rastet kur, ndryshimet metodologjike paraprihen nga një pilot, Grupi i Punës, i ngarkuar me ndjekjen e këtij procesi pasqyron dhe përmbledhjet statistikore ose analiza më të thelluara duke krahasuar rezultatet e mëparshme me rezultatet e prodhuara me përfshirjen e ndryshimit metodologjik. Këto statistika dhe raporte do të jenë më pas pjesë e dokumentacionit teknik që do të shoqërojë publikimin e produkteve të reja statistikore si rezultat i ndryshimit metodologjik.

6. Grupi i punës informon drejtorët e drejtorive, koordinatorët dhe Drejtorin e Përgjithshëm mbi ecurinë e procesit në mënyrë periodike me një frekuencë që përcaktohet në varësi të kohëzgjatjes që kërkon përgatitja e këtij ndryshimi. Përmbajtja e raporteve do të jetë më pas pjesë e dokumenteve që do të shoqërojnë ndryshimet metodologjike dhe do të pasurojnë politikat specifike të këtyre ndryshimeve.

7. Nëse, ndryshimet metodologjike parashikohet të kryhen në tregues të rëndësishëm makroekonomikë dhe kanë një thellësi impakti të konsiderueshëm në politikat e zhvillimit socio-ekonomik të vendit, Drejtori i Përgjithshëm mund të vendosë të ngrëjë një Grup Këshillues ad-hoc me ekspertë të fushave përkatëse që nuk janë punonjës të institucionit. Ky grup mund të ndihmojë analizat e impaktit parë nga një një vizion më i gjerë dhe të jetë pjesë mbështetëse e diskutimeve të INSTAT gjatë prezantimit të ndryshimeve në publik. Ai është në lidhje të vazhdueshme me Grupin e Punës, i cili i raporton mbi zhvillimet e procesit dhe shqyrtan komentet dhe sugjerimet e tij.

8. Pasi Grupi i Punës i ngarkuar me zbatimin e ndryshimit metodologjik përfundon procesin e analizimit dhe ka marrë miratimin e ndryshimit nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, e dokumenton dosjen e plotë të veprimtarisë në protokollin e INSTAT. Një relacion i shkurtër përgatitet edhe për Këshillin e Statistikave në mënyrë që të vihet në dijeni për ndryshimet metodologjike të ndodhura.

9. Informimi mbi përgatitjen për ndryshime metodologjike kryhet sipas kanaleve dhe procedurave të zakonshme të informimit nga ana e institucionit duke përdorur hapësirat përkatëse të faqes zyrtare por, në varësi të rëndësisë që mund të ketë ndryshimi për përdoruesit jashtë institucionit mund të organizohen tryeza të rrumbullakëta, konferenca shtypi, pasqyrim në median televizive nëpërmjet emisioneve informuese etj. (Referohu linkut në faqen zyrtare: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilësia-statistikore.aspx>).

10. Në përfundim të procesit të ndryshimeve metodologjike, me publikimin e rezultateve statistikore, duhet të publikohet dhe një dokument teknik që përmban: përshkrimin metodologjik nga ana e sektorit përkatës, arsyet e ndryshimit nga metodat e mëparshme, një listë të statistikave që do të ndryshojnë si rezultat i tij, përmbledhjet statistikore krahasuese të produkteve statistikore para dhe pas ndryshimit dhe/ose analizat e thelluara mbi masën e ndryshimit dhe përmirësimin e cilësisë.